

ASPEKTE TË FILOZOFISË SË GJUHËS TE FREGE, RUSSELL DHE
WITTGENSTEIN

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË FILOZOFI

Nga
BRAHIM MEHMETAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I FILOZOFISË

Prishtinë
Mars, 2023

EKSPOZE E TEMËS SË MASTERIT

“Aspekte të filozofisë së gjuhës te Frege, Russell dhe Wittgenstein”

Nga: Brahim Mehmetaj

Mentor: Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi

Në temën “Aspekte të filozofisë së gjuhës te Frege, Russell dhe Wittgenstein” jam përpjekur të jap një analizë të filozofisë dhe teorive të gjuhës të këtyre tre filozofëve të gjuhës të shekullit 19 dhe 20 dhe një shqyrtim kritik si dhe interpretim të teksteve të rëndësishme të këtyre tre autorëve. Analiza dhe kritika ishin edhe metodat kryesore të kësaj teme, ku theks i veçantë iu dha burimeve përkatësisht veprave kryesore të botuara në gjuhën shqipe nga këta autorë.

Gottlob Frege, Bertrand Russell dhe Ludwig Wittgenstein ishin pothuajse themeluesit të traditës analitike në filozofi, që kontribuan në vënien e bazave dhe dhanë elementet kryesore të kësaj filozofie apo kësaj rryme filozofike. Gjatë kësaj pune ata zhvilluan ide që hedhin dritë mbi gjuhën dhe mënyrën se si funksionon ajo aty ku bëhet shqyrtimi i problemeve filozofike, sidomos atyre të njohjes dhe metafizike e ontologjike. Në paraqitjen time jam përpjekur të ndalem te filozofia që mund të nxirret nga ai kontribut i tyre.

Teoria e gjuhës e Freges ka pasur një ndikim të madh në përgjithësi në zhvillimin e mëtejshëm të semantikës. Teorinë e vet të gjuhës Frege e prezanton në veçanti te artikulli *Mbi kuptimin dhe domethënien*, por pikëpamjen e tij për mendimin si fuptim të fjalisë kemi shqyrtuar më në detaje shkrimin e tij *Mendimi*.

Teorinë semantike të Freges si duket e ka kritikuar Russell, duke krijuar një teori të veten, që e gjejmë sidomos te “Mbi shënimin” dhe teoria e përshkrimeve te *Problemet e filozofisë*.

Wittgenstein nga ana tjetër, që u ka borxh shumë dy miqëve të vet Frege-s dhe Rasëllit, ka si duket dy qasje ndaj kuptimit të fjalëve, atë që e gjejmë te *Traktati logjiko-filozofik*, por edhe

atë që e gjejmë te *Hulumtimet Filozofike* e cila në njëfarë dore e kundërshton Traktatin, duke krijuar një teori të re, dhe mjaft frytdhënëse për relativizmin pragmatik të fjalëve dhe kuptimit të tyre.

Jam përpjekur që pas paraqitjes së teorive të Freges, Russell dhe Wittgenstein, të jap edhe disa implikime filozofike që rrjedhin nga teoritë e tyre gjuhësore, sidomos për sa i përket konceptimeve lidhur me objektet abstrakte, ekzistencën si dhe me objektet që nuk ekzistojnë në realitet.